



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 08 janar 2021
Nr. ref.:VE 1690/21

**VENDIM
PËR NDËRPRERJEN E
SHYQRTIMIT TË KËRKESËS**

në

rastin nr. KO56/20

parashtrues

**Rexhep Selimi dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit
të Republikës së Kosovës**

***Vlerësim i kushtetutshmërisë “së veprimit të Presidentit të Republikës
së Kosovës, të datës 23 mars 2020, të shprehur përmes konferencës për
media për mosrespektim dhe moszbatim të vendimit të Qeverisë së
Republikës së Kosovës”***

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa u parashtrua nga deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës: Rexhep Selimi, Yllza Hoti, Liburn Aliu, Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, Arbërie Nagavci, Hekuran Murati, Fitore Pacolli, Hajrullah Çeku, Saranda Bogujevci,

Jahja Koka, Mefail Bajçinovci, Valon Ramadani, Mimoza Kusari-Lila, Fitim Uka, Shpejtim Bulliqi, Artan Abrashi, Arbër Rexhaj, Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, Labinotë Demi- Murtezi, Alban Hyseni, Gazmend Gjyshinca, Arta Bajraliu, Enver Haliti, Agon Batusha, Dimal Basha, Fjolla Ujkani, Fitim Haziri, Elbert Krasniqi, Eman Rrahmani dhe Salih Zyba (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës).

2. Parashtruesit e kërkesës në procedurat para Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) u përfaqësuan nga deputetja Arbërie Nagavci.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesit e kërkesës kërkojnë vlerësimin e *"kushtetutshmërisë së veprimit të Presidentit të Republikës së Kosovës, të datës 23 mars 2020, të shprehur përmes konferencës për media për mosrespektim dhe moszbatim të vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës"*.
4. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë që "veprimi" i Presidentit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Presidenti) i shprehur përmes deklaratës së tij në konferencën për media (në tekstin e mëtejme: Deklarata e Presidentit) përbën shkelje serioze të Kushtetutës, respektivisht paragrafit 2 të nenit 84 [Kompetencat e Presidentit], paragrafëve 3 dhe 4 të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], paragrafit 1 i nenit 7 [Vlerat], paragrafëve 1 dhe 2 dhe paragrafi 4 i nenit 16 [Epërsia e Kushtetutës], paragrafit 4 të nenit 93 [Kompetencat e Qeverisë], nenit 97 [Përgjegjësia] dhe paragrafit 9 të nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit të Kosovës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).
5. Presidenti në deklaratën e tij të 23 marsit 2020 ishte shprehur si në vijim: *"Vendimi i Qeverisë sot është krejtësisht antikushtetues. Qytetarët nuk janë të detyruar t'i respektojnë vendimet kundërkushtetuese dhe askush nuk mund t'i dënoj ata për këtë. Po e ripërsëris: qytetarët nuk janë të detyruar t'i respektojnë vendimet antikushtetuese dhe askush nuk mund t'i dënoj ata për këtë. Nënvizoj: As Policia e Kosovës dhe organet e sigurisë nuk duhet të zbatojnë këtë vendim antikushtetues të Qeverisë sepse kështu edhe vet do të bëjnë vepër penale. E ripërsëris: As Policia e Kosovës dhe organet e sigurisë nuk duhet të zbatojnë këtë vendim antikushtetues të Qeverisë sepse kështu edhe vet do të bëjnë vepër penale. Vendimi i Qeverisë është pa efekt juridik të zbatueshëm dhe është i pazbatueshëm në tërë territorin e Republikës së Kosovës"*.
6. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu kërkojnë nga Gjykata mbajtjen e seancës dëgjimore publike.

Baza juridike

7. Kërkesa është e bazuar në paragrafin 6 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës], 44 [Saktësimi i kërkesës] dhe 45 [Afatet] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullat 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe i përgjigjeve] dhe 75 [Kërkesa në pajtim me nenin

113.6 të Kushtetutës dhe me nenet 44 dhe 45 të Ligjit] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

8. Më 31 mars 2020, parashtruesit e kërkesës dorëzuan kërkesën e tyre në Gjykatë. Përveç kërkesës me shkrim, parashtruesit po ashtu dorëzuan edhe audio-incizimin e deklaratës së Presidentit në konferencën për media të 23 marsit 2020.
9. Më 31 mars 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Selvete Gërzhaliu-Krasniqi dhe Radomir Laban (anëtarë).
10. Më 2 prill 2020, parashtruesit e kërkesës u njoftuan për regjistrimin e kërkesës dhe njëherit iu kërkuar që të caktojnë përfaqësuesin e tyre në procedurat para Gjykatës.
11. Po të njëjtën ditë, Gjykata njoftoi Presidentin, përkitazi me kërkesën, me udhëzimin që të dorëzojë në Gjykatë përgjigjen e tij përkitazi me kërkesën, deri më 17 prill 2020. Kërkesa iu komunikua edhe Kryetares së Kuvendit të Republikës së Kosovës, znj. Vjosa Osmani-Sadriu, me udhëzimin për dorëzimin e kërkesës te të gjithë deputetët e Kuvendit, dhe Kryeministrit në detyrë të Republikës së Kosovës, z. Albin Kurti, duke i ftuar që t'i dorëzojnë Gjykatës komentet, nëse kanë, deri më 17 prill 2020. Kërkesa gjithashtu iu komunikua Sekretarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës.
12. Më 2 prill 2020, përmes postës elektronike Gjykata u njoftua se për qëllim të zhvillimit të komunikimit përkitazi me kërkesën, parashtruesit e kërkesës do t'i përfaqësojë deputetja Arbërie Nagavci.
13. Më 17 prill 2020, Presidenti dorëzoi përgjigjen e tij ndaj pretendimeve të ngritura në kërkesën e parashtruesve.
14. Më 22 prill 2020, Gjykata njoftoi përfaqësuesen e parashtruesve të kërkesës për pranimin e përgjigjes së dorëzuar nga Presidenti dhe e ftoi që komentet e tyre ndaj përgjigjes, nëse kanë, t'i dorëzojnë me shkrim jo më vonë se më 5 maj 2020. Të njëjtën ditë, përgjigja e Presidentit ndaj pretendimeve të ngritura në kërkesën e parashtruesve iu komunikua edhe Kryetares së Kuvendit të Republikës së Kosovës, me udhëzimin për dorëzimin e kopjes së përgjigjes te të gjithë deputetët e Kuvendit, dhe Kryeministrit në detyrë të Republikës së Kosovës.
15. Më 5 maj 2020, parashtruesit e kërkesës dorëzuan në Gjykatë komentet e tyre ndaj përgjigjes së Presidentit.
16. Më 8 maj 2020, komentet e dorëzuara të parashtruesve të kërkesës ndaj përgjigjes së Presidentit iu komunikuan Presidentit, Kryetares së Kuvendit të Republikës së Kosovës, me udhëzimin për dorëzimin e kopjes së komenteve te të gjithë deputetët e Kuvendit, dhe Kryeministrit në detyrë të Republikës së Kosovës.

17. Më 14 tetor 2020, Gjykata shqyrtoi rastin dhe vendosi që vendimmarrjen për këtë rast ta shtyjë për një seancë tjetër.
18. Më 5 nëntor 2020, Presidenti i Republikës së Kosovës z. Hashim Thaçi, dha dorëheqje nga pozita e Presidentit të Republikës së Kosovës.
19. Më 5 nëntor 2020, Kryetarja e Kuvendit, znj. Vjosa Osmani- Sadriu filloi ushtrimin e postit të ushtrueses së detyrës të Presidentes së Republikës së Kosovës.
20. Më 17 dhjetor 2020, Kolegji Shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës që të urdhërojë ndërprerjen e procedurës së shqyrtimit të kërkesës. Rrjedhimisht, Gjykata në përputhje me nenin 113.6 të Kushtetutës, nenet 44 dhe 45 të Ligjit dhe paragrafin (5) të rregullit 75 të Rregullores së punës vendosi që të urdhërojë ndërprerjen e shqyrtimit të kërkesës së parashtruesve të kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

21. Duke filluar nga 11 marsi 2020 e tutje, Qeveria nxori disa vendime që ndërlidhen me pandeminë COVID-19. (Vendimet nr. 01/07 të 11 marsit 2020; nr. 01/08 të 12 marsit 2020; nr. 01/09 të 13 marsit 2020; nr. 02/09 të 13 marsit 2020; nr. 01/10 të 14 marsit 2020; nr. 01/11 të 15 marsit 2020; nr. 01/12 të 17 marsit 2020; nr. 01/13 të 18 marsit 2020).
22. Më 15 mars 2020, me kërkesë të Ministrisë së Shëndetësisë së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ministria e Shëndetësisë) Qeveria e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Qeveria) nxori Vendimin [nr. 01/11] për shpalljen e “emergjencës për shëndetin publik”.
23. Më 23 mars 2020, Qeveria në bazë të kërkesës së Ministrisë së Shëndetësisë nxori Vendimin [nr. 01/15] përmes të cilit miratoi ndërmarrjen e masave për parandalimin dhe kontrollin e përhapjes së pandemisë COVID-19, si në vijim:

“1. Ndalohet qarkullimi i qytetarëve dhe automjeteve private nga 24 mars 2020 gjatë orës 10:00 – 16:00 dhe prej orës 20:00 – 06:00, përveç për nevoja mjekësore, prodhim, furnizim dhe shitje të mallrave esenciale (ushqim dhe barna për njerëz dhe kafshë/shpezë), dhe për shërbime dhe aktivitete që ndërlidhen me menaxhim të pandemisë (menaxhmenti dhe personeli esencial qeveritar dhe komunal nga këta sektorë: shëndetësi, siguri dhe administratë shtetërore;

2. Mundësohet qarkullimi i lirë për operatorët ekonomik të klasifikuar si me të rëndësishme sipas kodeve NACE që Ministria e Ekonomisë, Punësimi, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike lejon të operojnë në këtë periudhë emergjente lidhur me pandeminë COVID-19, si dhe transporti i lirë i mallërave/shërbimeve për të siguruar funksionimin e zinxhirit të furnizimit.

3. Lëvizjet në rrugë bëhen jo më shumë se nga dy persona së bashku dhe gjithmonë duke mbajtur distancën dy metra me të tjerët.

4. Ndalohen tubimet në të gjitha mjediset - private dhe publike, të hapura dhe të mbyllura - përveç kur është e domosdoshme për të kryer detyrat e punës për parandalim dhe luftim të pandemisë, si dhe ku lejohet distanca dy metra me të tjerët. Në rast të vdekjeve, në varrim mund të marrin pjesë vetëm anëtarët e ngushtë të familjes së të vdekurit dhe personat që kryejnë shërbimin e varrimit.

5. Obligohen Institucionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës të ndërmarrin veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij Vendimi. [...].”

24. Po të njëjtën ditë, Presidenti në një konferencë për media deklaroi se "Vendimi i Qeverisë sot është krejtësisht antikushtetues. Qytetarët nuk janë të detyruar t'i respektojnë vendimet kundërkushtetuese dhe askush nuk mund t'i dënoj ata për këtë. Po e ripërsëris: qytetarët nuk janë të detyruar t'i respektojnë vendimet antikushtetuese dhe askush nuk mund t'i dënoj ata për këtë. Nënvizoj: As Policia e Kosovës dhe organet e sigurisë nuk duhet të zbatojnë këtë vendim antikushtetues të Qeverisë sepse kështu edhe vet do të bëjnë vepër penale. E ripërsëris: As Policia e Kosovës dhe organet e sigurisë nuk duhet të zbatojnë këtë vendim antikushtetues të Qeverisë sepse kështu edhe vet do të bëjnë vepër penale. Vendimi i Qeverisë është pa efekt juridik të zbatueshëm dhe është i pazbatueshëm në tërë territorin e Republikës së Kosovës". (Parashtruesit e kërkesës në Gjykatë dorëzuan edhe audio-incizimin e deklaratës së Presidentit për media.)
25. Më 5 nëntor 2020, Presidenti i Republikës së Kosovës z. Hashim Thaçi, dha dorëheqje nga pozita e Presidentit të Republikës së Kosovës.
26. Më 5 nëntor 2020, Kryetarja e Kuvendit Znj. Vjosa Osmani - Sadriu filloi ushtrimin e postit të ushtrueses së detyrës të Presidentes së Republikës së Kosovës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

27. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës pretendojnë se deklarata e Presidentit, e dhënë në konferencën për media përbën shkelje serioze të Kushtetutës, respektivisht nenit 84 [Kompetencat e Presidentit] paragrafit 2, nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] paragrafët 3 dhe 4, nenit 7 [Vlerat] paragrafi 1, nenit 16 [Epërsia e Kushtetutës], paragrafët 1, 2 dhe 4, nenit 93 [Kompetencat e Qeverisë], paragrafi 4, nenit 97 [Përgjegjësia] dhe nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit të Kosovës] paragrafi 9 të Kushtetutës.
28. Në kërkesën e tyre, parashtruesit e kërkesës theksojnë se "veprimet antikushtetues të Presidentit të Republikës së Kosovës duhet t'i vihet theksi në katër elemente: (i) "Vendimi i Qeverisë sot është krejtësisht antikushtetues": (ii) "Qytetarët nuk janë të detyruar t'i respektojnë vendimet kundërkushtetuese dhe askush nuk mund t'i dënoj ata për këtë": (iii) "As Policia e Kosovës dhe organet e sigurisë nuk duhet të zbatojnë këtë vendim antikushtetues të Qeverisë sepse kështu edhe vet bëjnë vepër penale"; (iv) "Vendimi i Qeverisë është pa efekt juridik të zbatueshëm dhe është i pazbatueshëm në tërë territorin e Republikës së Kosovës".
29. Në kontekst të pretendimeve të tyre, parashtruesit e kërkesës, fillimisht në vijim nënvizojnë se në sistemin kushtetues të Republikës së Kosovës "[...] Presidenti i

Republikës së Kosovës si pushtet neutral apo si përfaqësues i pushtetit asnjëans, pra, që qëndron mbi palët, nuk hyn në ndarjen e pushteteve dhe nuk kryen asnjë funksion ekzekutiv në drejtimin politik të vendit. Pikërisht në këtë drejtim përcaktohet statusi i Presidentit të Republikës së Kosovës në kuptim të asaj se "Presidenti është kreu i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit të Republikës së Kosovës". Në vijim, parashtruesit arsyetojnë se "Presidenti i Kosovës nuk lejohet t'i përfaqësojë interesat grupore ose politike partiake por i përfaqëson të gjithë së bashku, që i jep kuptim substancial përfaqësimit të unitetit të popullit të një shteti. Mbi bazën e këtij statusi, Presidentit të Kosovës i janë përshkruar kompetenca kushtetuese për të materializuar rolin e tij si pushtet balancues apo "mediator institucionesh", apo pushtet asnjëans". Në këtë kontekst, parashtruesit e kërkesës nënvizojnë se njëra nga kompetencat më të rëndësishme të Presidentit është ajo e të qenit "garantues i funksionimit kushtetues të institucioneve të përcaktuara" me Kushtetutë".

30. Sipas parashtruesve të kërkesës, "Garantimi i funksionimit kushtetues dhe demokratik të institucioneve kushtetuese të përcaktuara me këtë Kushtetutë nga ana e Presidentit të Republikës së Kosovës, realizohet me ushtrimin e kompetencave të tij kushtetuese". Parashtruesit e kërkesës, duke iu referuar parimit të ndarjes së pushteteve theksojnë se "Pushteti shtetëror nuk u nënshtrohet vetëm kufizimeve të parapara me Kushtetutë dhe ligje, por edhe atyre kufizimeve të cilat i parasheh edhe parimi i ndarjes së pushtetit dhe të cilat nuk lejojnë që në duart e një organi të vendosen funksione të ndryshme pushteti". Në vijim, parashtruesit arsyetojnë se "Mbi bazën e nenit 4 dhe 7 të Kushtetutës dhe mbi bazën e një mekanizimi kushtetues (kompetencë), që e pajisë Presidentin e Republikës për garantim dhe funksionim kushtetues të institucioneve kushtetuese, ndahet pushteti shtetëror midis organit ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor, duke përfshirë edhe kontrollin dhe balancimin midis tyre, si dhe përcaktimin e kompetencave kushtetuese në mënyrë taksative. Pra vetëm në këtë mënyrë ndahet dhe ushtrohet pushteti shtetëror në mënyrë të pavarur. Kësisoj, degët e pushtetit shtetëror dhe kompetencat e tyre, duke përfshirë edhe Presidentin e Kosovës që nuk hyn në ndarjen pushtetit shtetëror, janë të shtrira nëpër dispozita kushtetuese të caktuara". Në kontekst të këtij pretendimi, parashtruesit e kërkesës theksojnë se vendimet dhe aktet juridike të Qeverisë, të nxjerra sipas nenit 93, paragrafit 4 të Kushtetutës mund të "kontestohen vetëm nga Gjykata Kushtetuese" në pajtim me juridiksionin e saj, të përcaktuar me nenin 113 të Kushtetutës.
31. Parashtruesit e kërkesës specifikojnë se "[...] çështja nëse Presidenti ka kryer shkelje serioze kushtetuese, duke bërë thirrje për moszbatimin e Vendimit të Qeverisë, është krejt e pavarur nga çështja, a ishte i saktë mendimi i Presidentit që masat e përcaktuara të Vendimit janë vërtet kundërkushtetuese". Sipas parashtruesve të kërkesës, Presidenti në konferencën për media "[...] nuk është ndalur thjesht të shprehja e mendimit. Përkundrazi, ai ka tejkaluar të gjitha limitet kompetencave të veta si president, duke e vendosur veten në rolin e gjykatës". Në kuptim të kësaj, parashtruesit duke iu referuar nenit 102, paragrafit 3 dhe nenit 112, paragrafit 1 të Kushtetutës theksojnë se është kompetencë e gjykatave të shpallin vendimet e Qeverisë si kundërkushtetuese, në të cilin qytetarët, forcat e rendit dhe institucionet e tjera udhëzohen për moszbatimin e këtyre vendimeve. Në dritën e këtij arsyetimi, parashtruesit konkludojnë se "Cilido zyrtar tjetër që bën thirrje për moszbatim të vendimeve

të Qeverisë, në bazë të mendimit të vet se të njëjtat janë kundërkushtetuese, e uzurpon kompetencën ekskluzive të gjykatave, cenon rëndë rendin kushtetues dhe ligjor të vendit, si dhe e shkel në mënyrë flagrante ndarjen demokratike të pushteteve, në mes gjykatave dhe institucioneve të tjera. Në këtë mënyrë, duke iu bërë thirrje qytetarëve dhe forcave të rendit për të mos e respektuar Vendimin e Qeverisë, presidenti ka kryer shkelje serioze të Kushtetutës”.

32. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se “Gjykata Kushtetuese është organ kushtetues të cilës i është dhënë kompetenca e kontrollit kushtetues - procedural dhe material - të akteve të autoriteteve publike me të drejtën e shpalljes së tyre si të pavlefshme nën arsyetimin e mospërputhjes së tyre me Kushtetutën”. Sipas tyre, një kompetencë e tillë si e Gjykatës Kushtetuese nuk i është dhënë organeve të tjera, dhe as Presidentit.
33. Në vijim, parashtruesit e kërkesës, duke iu referuar nenit 97 [Përgjegjësia] dhe paragrafit 9 të nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës, arsyetojnë se “Raporti ndërmjet pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ realizohet përmes ushtrimit, funksionimit, balancimit dhe kufizimit midis tyre, me participimin e Presidentit si garant i funksionimit kushtetues dhe demokratik të institucioneve të përcaktuara me këtë Kushtetutë”.
34. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se “me veprimin e tij antikushtetues në formë deklarimi publik” Presidenti ka bërë shkelje serioze të Kushtetutës, duke “cenuar pavarësinë ndarjes së pushtetit shtetëror të përcaktuar me nenin 4 dhe 7 të Kushtetutës, përmes realizimit të elementeve të veprimit antikushtetues të shprehur në pikën III të kësaj kërkesë. Respektimi i parimit të ndarjes së pushteteve nga ana e Presidentit të Kosovës, nënkupton aktivizimin e nenit 84 par. 2 dhe nenit 4 par. 3 të Kushtetutës së Kosovës”.
35. Parashtruesit e kërkesës, në vazhdim, duke iu referuar nenit 16 [Epërsia e Kushtetutës] të Kushtetutës arsyetojnë se nga kjo dispozitë “mund të nxirren dy veçori kushtetuese lidhur me ushtrimin e pushtetit shtetëror. E para, organet e pushtetit shtetëror e ushtrojnë veprimtarinë e vetë përmes akteve juridike të bazuara në Kushtetutë dhe ligj dhe, e dyta, organet e pushtetit shtetëror duhet t'i respektojnë dispozitat kushtetuese”. Në këtë kontekst, parashtruesit e kërkesës theksojnë se “[...] veprimet e [Presidentit] nuk burojnë nga Kushtetuta, duke mos përjashtuar as cenimin e dispozitave kushtetuese lidhur me ushtrimin kompetencës kushtetuese të përcaktuar në nenin 84, par. 2 lidhur me nenin 4, par. 3 të Kushtetutës së Kosovës”.
36. Në vijim, parashtruesit e kërkesës nënvizojnë se “Raporti kushtetues i ndarjes, ushtrimit, kontrollimit dhe balancimit të pushtetit ndërmjet organit legjislativ dhe ekzekutiv mund kuptohet nga dispozitat konkrete të përcaktuara në nenin 65 par. 9, nenin 93 par. 4 dhe nenin 97 të Kushtetutës”. Rrjedhimisht, sipas parashtruesve të kërkesës, Presidenti “[...] me veprimin antikushtetues me të cilin ka bërë thirrje që të mos zbatohen vendimet e Qeverisë nga qytetarët, policia dhe organet e sigurisë së Kosovës, ka ndërhyrë dhe cenuar nenin 93 par. 4 lidhur me nenin 97, si dhe nenin 65 par. 9 të Kushtetutës”.
37. Sipas parashtruesve të kërkesës “[...] ndonëse Kuvendi është organ të cilit i është njohur funksioni kontrollues i punës së Qeverisë, as Kryetari i Kuvendit të

Kosovës nuk e ka të drejtën për të bërë thirrje që të mos zbatohen vendimet e miratuara nga ekzekutivi. Në rast se Kryetari i Kuvendit apo cilido deputet konsideron se një akt i Qeverisë është në kundërshtim me Kushtetutën, ai mund të kërkojë mbështetjen e numrit të nevojshëm të deputeteve që çështjen ta referojë në Gjykatën Kushtetuese”.

38. *Parashtruesit e kërkesës duke arsyetuar se përgjegjësia e Qeverisë së Kosovës, e përcaktuar me nenin 97, është e lidhur me nenin 65, paragrafin 9 të Kushtetutës, ritheksojnë se “[...] me veprimin antikushtetues të Presidentit të Kosovës, është krijuar një ndërhyrje antikushtetuese në kompetencën e Kuvendit të Kosovës [...]”.*
39. *Në dritën e elaborimit të pretendimeve të tyre, parashtruesit e kërkesës duke iu referuar rastit të Gjykatës KO47/10, parashtrues Naim Rrustemi dhe 31 deputetë tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës sugjerojnë se “[...] për të konkluduar që Presidenti i Republikës së Kosovës ka bërë shkelje serioze të Kushtetutës, duhet vlerësuar ndikimin e veprimit antikushtetues të Presidentit në besueshmërinë e publikut, lidhur me numrin e madh të kompetencave kushtetuese që i janë dhënë, dhe kësaj mbi bazën e këtyre kompetencave është e drejtë të supozohet se Presidenti përfaqëson unitetin e popullit, e jo të interesave të grupeve apo partive politike të caktuara. Mbi bazën e kësaj, kompetencat kushtetuese që i janë dhënë me kushtetutë Presidentit të Republikës së Kosovës, kanë për qëllim të materializojnë përfaqësimin e unitetit të popullit përmes ushtrimit të kompetencave të tij kushtetuese. Kompetencat kushtetuese të përcaktuara në nenin 84 të Kushtetutës, reflektojnë nivelin adekuat të besueshmërisë publike mbi rolin e Presidentit në ushtrimin e kompetencave të tij kushtetuese”. Sipas parashtruesve të kërkesës “[...] shkelja e qëllimshme dhe me paramendim e nenit 84, par. 2 lidhur me nenin 4, par. 3 dhe 7, nenit 16, par. 1, 3 dhe 4, nenit 93 par. 4 lidhur me nenin 4 par. 4, nenit 97 lidhur me nenin 65 par. 9 të Kushtetutës, me veprimin e tij antikushtetues sipas pikës III [Arsyetimi i kërkesës dhe shkeljet e pretenduara të Kushtetutës] të kësaj Kërkesë, ka bërë që niveli i besueshmërisë publike të Presidentit të cenohet skajshmërisht”.*
40. *Rrjedhimisht, parashtruesit e kërkesës përfundojnë se “[...] sipas provave dhe argumenteve të paraqitura në këtë Kërkesë, mund të faktohet se Presidenti i Republikës së Kosovës ka kryer shkelje serioze të "qëllimshme dhe me paramendim" të dispozitave të Kushtetutës të shtjelluara brenda kësaj kërkesë”.*
41. *Si përfundim, parashtruesit e kërkesës, duke iu referuar gjendjes emergjente të shëndetit publik konsiderojnë se “[...] moszbatimi i masave të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë, sidomos në këtë fazë kritike të përhapjes së virusit, do të mund ta çojë virusin në rritje eksponenciale, gjë që, deri tani, Republika e Kosovës, falë punës dhe përkushtimit të mjekëve, infermierëve dhe autoriteteve mjekësore, ka arritur të parandalojë. Duke marrë parasysh këtë situatë tepër të ndjeshme, në të cilën ndodhet Republika e Kosovës, thirrja e presidentit për të mos i zbatuar masat e Qeverisë, ka rrezikuar drejtpërsëdrejti shëndetin dhe jetën e qytetarëve. Në këtë aspekt, shkelja kushtetuese të cilën e ka kryer presidenti, arrin deri në nivelin më të lartë të mundshëm të seriozitetit”.*

42. Rrjedhimisht, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata që: *“veprimi antikushtetues i Presidentit të Republikës së Kosovës të vlerësohet si shkelje serioze e Kushtetutës, sipas dispozitave të caktuara kushtetuese të përcaktuara dhe argumentuara në përmbajtjen e kësaj Kërkesë”*.
43. Në fund, parashtruesit e kërkesës kërkojnë që Gjykata ta shpallë kërkesën e tyre të pranueshme dhe të konstatojë *“shkelje serioze të Kushtetutës, respektivisht të neneve 84, par. 2 lidhur me nenin 4 par. 3 dhe 7 par. 1, nenit 16, par. 1, 2 dhe 4, nenit 97 lidhur me nenin 65, par. 9 të Kushtetutës, nga presidenti i republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi”*.

Kërkesa e parashtruesve të kërkesës për mbajtjen e seancës dëgjimore publike

44. Parashtruesit në kërkesën e tyre, kanë kërkuar mbajtjen e seancës dëgjimore publike. Në lidhje me këtë kërkesë, parashtruesit e kërkesës theksojnë se *“[...] është në interes publik që të mbahet kjo seancë dëgjimore publike, për shkak se rasti në fjalë afekton jo vetëm organet shtetërore dhe kompetencat e tyre kushtetuese por edhe shoqërinë në tërësi. Ashtu siç është argumentuar më lart, veprimi antikushtetues i Presidentit cenon parime të rëndësishme të funksionimit të Republikës sonë”*.

Përgjigja e Presidentit

45. Fillimisht, Presidenti në përgjigjen e tij sqaron se *“para se të komentohen pretendimet e parashtruesve të kërkesës në rastin KO56/20, si dhe deklarata publike e Presidentit, në konferencën për media të datës 23.03.2020, të cilën parashtruesit e kërkesës pretendojnë se gjoja kjo deklarata përbën shkelje serioze të Kushtetutës, duhet komentuar edhe veprimet paraprake të Presidentit, para mbajtjes së kësaj konference (23.03.2020), por edhe vetë qëllimin e konferencës dhe deklaratave të dhëna nga Presidenti. Këtu duhet pasur parasysh rrjedhën e veprimeve të Presidentit si tërësi dhe jo vetëm një deklaratë të shkëputur nga konferenca për media që i referohen parashtruesit e kërkesës”*.
46. Presidenti, në kuptimin e një deklarate të përgjithshme ndaj pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, theksoi se: *“Konferenca e Presidentit e mbajtur më datë 23.03.2020 dhe deklarimet e Presidentit gjatë konferencës kanë qenë në tërësi në përputhje me fushëveprimin kushtetues dhe kompetencat e Presidentit, veçanërisht duke pasur parasysh nenin 4, paragrafi 3, nenin 83 dhe nenin 84, paragrafi 2 i Kushtetutës [...]. Sipas Presidentit, në bazë të këtyre kompetencave të përcaktuara me Kushtetutë: “Që të tria këto kompetenca përbëjnë boshtin kryesor të Presidentit në sistemin kushtetues të Kosovës. Presidenti përmes ushtrimit të këtyre kompetencave materializon të gjitha kompetencat tjera të cilat ia garanton Kushtetuta dhe kujdeset për balancimin e pushteteve, si dhe funksionimin demokratik të institucioneve kushtetuese në Republikën e Kosovës”*.
47. Duke u bazuar në arsyetimin e lartcekur, Presidenti specifikon se *“Duke pasur parasysh se [Presidenti] është përfaqësues i unitetit të popullit, i njëjti para se gjithash duhet pasur parasysh interesin e qytetarëve të Republikës së Kosovës,*

përfshirë edhe komunitetet jo-shumicë, siç përcaktohen në Kushtetutë”. Në këtë drejtim, Presidenti specifikon se: “Duke pasur interesin qytetar, pikërisht kur e gjithë bota po përballet me pandeminë COVID-19, Presidenti ka ndërmarrë veprime të rëndësishme me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve nga pandemia, por edhe më gjerë”.

Arsyetimi përkitazi me veprimet për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme

48. Në këtë drejtim, Presidenti i referohet veprimeve të tij të ndërmarra në lidhje me shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme duke sqaruar se: *“Më datë 17.03.2020, Presidenti ka zhvilluar konsultime me Kryeministrin dhe akterët tjerë për shpalljen e Gjendjes së Jashtëzakonshme, sipas nenit 131 të Kushtetutës. Bazuar në kompetencat e tij dhe mbi të gjitha në funksion të përfaqësimit të unitetit të popullit [...] Presidenti ka kërkuar nga Kryeministri që në pajtim me nenin 127 paragrafi 3 të Kushtetutës dhe nenin 5.4 të Ligjit nr. 03/L-050 për themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës [...] të thirret takimi i Këshillit të Sigurisë së Kosovës [...] më datë 18.03.2020, Presidenti ka kërkuar nga Kryeministri që të thirret takimi i Këshillit të Sigurisë së Kosovës me qëllim të njoftimit për shpalljen e Gjendjes së Jashtëzakonshme për shkak të fatkeqësisë natyrore, takim ky i cili nuk është thirrur nga Kryeministri Kurti, me gjithë obligimin kushtetues dhe ligjor që ka për ta bërë një gjë të tillë. Duhet theksuar se gjatë gjithë procesit të konsultimit me presidentin për Shpalljen e Gjendjes së Jashtëzakonshme, Kryeministri ka refuzuar me ashpërsi dhe pa asnjë argument shpalljen e Gjendjes së Jashtëzakonshme”. Në kontekst, të këtij pretendimi, Presidenti në përgjigjen e tij ka bashkëngjitur shkresat e dërguara Kryeministrit për këtë qëllim.*
49. Tutje, sa i përket çështjes së shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme, Presidenti arsyeton se shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme do të evitonte dhe pamundësonte shkeljen e të drejtave të njeriut, të garantuara me Kapitullin II dhe III të Kushtetutës. Në këtë aspekt, Presidenti po ashtu i referohet Aktgjykimit të Gjykatës në rastin nr. KO29/12 dhe KO48/12 [Vlerësimi i amendamenteve të propozuara kushtetuese, të dorëzuara nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, më 23 mars 2012 dhe 4 maj 2012, Aktgjykim i 20 korrikut 2012, paragrafit 161].
50. Në këtë drejtim, Presidenti shton: *“Pikërisht duke pasur parasysh rrezikun e cenimit, pakësimit dhe rrezikimit të lirive dhe të drejtave të njeriut, duke u bazuar në detyrën për të përfaqësuar unitetin e popullit dhe garantimin e demokratik të institucioneve, deklarata e Presidentit në konferencën e datës 23.03.2020 ka qenë në interesin e përfaqësimit më të mirë të unitetit të popullit të Kosovës dhe mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të tyre, që garantohen në Kapitullin II të Kushtetutës, deklarata të cilën parashtruesit e kërkesës tentojnë ta paraqesin si gjoja shkelje e Kushtetutës”.*
51. Po ashtu, Presidenti shton se Gjykata në rastet KO29/12 dhe KO48/12 në paragrafin 254 kishte përcaktuar: *“Që nga data e zgjedhjes së Presidentit të Republikës nga Kuvendi, ajo u bë përfaqësuese legjitime e vendit, brenda dhe jashtë, si dhe garantuese e funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës”. Presidenti më tej shton: “Andaj detyra e Presidentit për garantimin e funksionimit demokratik të institucioneve është një detyrë e*

përhershme dhe e vazhdueshme, të cilin e kryen gjithnjë duke pasur parasysh edhe përfaqësimin e popullit dhe mbrojtjes së interesave të qytetarëve”.

52. Në vijim, Presidenti qëllimin e tij për mbajtjen e konferencës për media më 23 mars 2020 e arsyeton si në vijim: *“Konferenca e Presidentit e datës 23.03.2020 është realizuar në vazhdimësi të veprimeve të Presidentit për shpalljen e Gjendjes së Jashtëzakonshme, me qëllim të parandalimit të pasojave të pandemisë COVID-19 në jetën qytetarëve dhe mbrojtjes nga pakësimi dhe cenimi i të drejtave të njeriut që përcaktohen në Kapitullin II të Kushtetutës. Presidenti është përfaqësues i popullit të Republikës së Kosovës dhe garanton funksionimin demokratik dhe kushtetues të institucioneve të Republikës së Kosovës. Andaj, në konferencën e datës 23.03.2020, Presidenti ka pasur për qëllim dhe synim vetëm përfaqësimin e interesave dhe unitetit të popullit të Kosovës, garantimin e funksionimit demokratik të institucioneve kushtetuese dhe respektimin e vlerave të cilat i përcakton Kushtetuta në nenin 7”. Rrjedhimisht, Presidenti shprehet se deklarata e tij në konferencën për media ka synuar dhënien “e mesazhit të qartë se [Presidenti] do të kujdeset për mbrojtjen e tyre dhe do të marrë veprime kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave të tyre të garantuara në Kapitullin e II të Kushtetutës, duke kontestuar kushtetutshmërinë e Vendimit të Qeverisë në Gjykatën Kushtetuese.*
53. Presidenti më tej shton se pikërisht sipas këtij zotimi të dhënë në deklaratë, më 24 mars 2020 në Gjykatën Kushtetuese ka dorëzuar kërkesën e tij për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të Qeverisë. Në këtë drejtim, Presidenti po ashtu sqaron se *“Po të njëjtën ditë (24.03.2020) ka kërkuar nga Kryeministri që të shfuqizojë vendimin ose së paku të pezullojë implementimin e tij deri në vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Po të njëjtën ditë, më datë 24.03.2020, Presidenti ka kërkuar sërish nga Kryeministri që të thirret takimi i Këshillit të Sigurisë së Kosovës me qëllim të diskutimit të zhvillimeve të fundit të gjendjes së sigurisë në Republikën e Kosovës. Ky takim sërish nuk është thirrur nga Kryeministri Kurti, me gjithë obligimin kushtetues dhe ligjor që ka për ta bërë një gjë të tillë”.* Përkitazi me këtë, Presidenti në përgjigjen e tij, bashkëngjiti shkresat e 24 marsit 2020 dërguar Kryeministrit.
54. Përkitazi me kërkesën e tij dorëzuar në Gjykatë, Presidenti vë në dukje se përmes Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KO54/20, Vendimi i Qeverisë u shpall në papajtueshmëri me nenet 55, 43, 35, 36 të Kushtetutës dhe nenet 8 dhe 11 të KEDNJ-së në lidhje me nenin 2 të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së.
55. Në adresimin e deklaratës për moszbatim të vendimit të Qeverisë, Presidenti theksoi se: *“[...] deklarata për moszbatimin e vendimit nga qytetarët dhe nga ana e organeve kompetente është adresuar nga Presidenti gjithnjë me bindjen e tij të thellë se vendimi cenon dhe pakëson të drejtat e njeriut të përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës, si dhe zbatimi i të njëjtit do të shkaktonte pasoja kundërkushtetuese tek organet në raport me të drejtat e njeriut. Në fakt, ky efekt edhe është arritur për shkakun se bazuar në këtë vendim janë kufizuar të drejtat e njeriut dhe janë bërë arrestime të qytetarëve të cilat nuk e kanë respektuar Vendimin e Qeverisë nr. 01/15, datë 23.03.2020. Raportime të tilla ka pasur vazhdimisht në media dhe se këto veprime mund të prodhojnë pasoja juridike në rast të ankesës së qytetarëve të arrestuar apo edhe qytetarëve të*

tjerë që mund të pretendojnë që i janë shkelur të drejtat tjera, përveç asaj të lëvizjes”.

56. Presidenti, po ashtu, shton: *“Presidenti asesi nuk mund t’i lejonte qytetarët, unitetin e të cilëve e përfaqëson, por as institucionet tjera që të ndërmarrin veprime, bazuar në një Vendim të Qeverisë, i cili u vërtetua që është në kundërshtim me Kushtetutën, sipas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin KO54/20. Mbi të gjitha, Presidenti si kujdestar i funksionimit demokratik dhe kushtetues të institucioneve nuk mund të lejonte që Qeveria të ndërhynte në pushtetin kushtetues që i takon Kuvendit, apo thënë ndryshe të cenoheshin kompetencat e Kuvendit dhe kështu parimi i ndarjes së pushteteve në Republikën e Kosovës. Gjykata Kushtetuese në rastin KO54/20 (dispozitivi i Aktgjykimit) konstatojë që kufizimi i lirive dhe të drejtave të njeriut mund të bëhet vetëm me ligj. Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 65 paragrafi 1 përcakton: Kuvendi i Republikës së Kosovës: (1) miraton ligje, rezoluta dhe akte tjera të përgjithshme. Andaj me rastin e nxjerrjes së vendimit nr.01/15, datë 23.03.2020, Qeveria e Republikës së Kosovës ndërhyri në kompetencat e Kuvendit, duke rregulluar me vendim një materie që do të duhej të rregullohej me ligj, sipas nenit 55 paragrafi 1”. Në këtë aspekt, Presidenti nënvizon se “ndërhyrja në kompetencat e organeve tjera kushtetuese prodhon “konflikt kompetencash” dhe kjo situatë pamundëson funksionimin demokratik dhe kushtetues të institucioneve”.*
57. Presidenti thekson: *“Pra, Qeveria me Vendimin e saj ka ndërhyrë në kompetencat e Kuvendit dhe kështu ka cenuar parimin e ndarjes së pushteteve, garantues i balancimit të të cilit është Presidenti i Republikës së Kosovës. Bazuar në këtë praktikë të Gjykatës Kushtetuese dhe në dispozitat e Kushtetutës, Presidenti ka për detyrë që të mbrojë parimet demokratike dhe vlerat kushtetuese, në bazë të kompetencave, në këtë rast në bazë të adresimit të rastit në Gjykatën Kushtetuese, por edhe informimin e qytetarëve për këtë. Mbi të gjitha, në linjë me këtë, Presidenti ka për detyrë që t’i sigurojë qytetarët dhe popullin e Kosovës duke përcjellë mesazhe tek ata se Qeveria dhe organet tjera kushtetuese janë duke vepruar në pajtim me Kushtetutën, ligjet dhe vlerat demokratike të mishëruara në Kushtetutë”.*

Në lidhje me pretendimin e parashtresve të kërkesës për shkelje të nenit 4, paragrafët 3 dhe 4 në lidhje me nenin 84 të Kushtetutës, paragrafi 2

58. Në lidhje me këtë pretendim, Presidenti sqaron se nuk ka shkelur parimin e ndarjes së pushteteve, të përcaktuar me nenin 4 të Kushtetutës. Sipas tij, *“përmes veprimeve të tij ka kontribuar që të mbrohet parimi i ndarjes së pushteteve, të cilin e kishte shkelur Qeveria përmes nxjerrjes së Vendimit nr. 01/15, datë 23.03.2020”. Në adresimin e këtij pretendimi, Presidenti në përgjigjen e tij shton se: “Presidenti është i obliguar që në bazë të nenit 84, paragrafi 2 dhe nneit 4, paragrafi 3 të ndërmarrë veprime që të garantojë funksionimin kushtetues dhe demokratik të institucioneve”.*
59. Presidenti në përgjigjen e tij theksoi: *“Presidenti në asnjë mënyrë nuk e ka shkelur nenin 4, paragrafi 3 dhe nenin 84, paragrafi 2 të Kushtetutës. Përkundrazi, Presidenti në konferencën përkatëse të datës 23.02.2020 ka realizuar ato nene, duke garantuar funksionimin demokratik dhe kushtetues të*

institucioneve, pasi që ndërmori masa konkrete për të parandaluar pasojat kundërkushtetuese të Vendimit Nr. 01/15, datë 23.03.2020, me qëllim të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut që burojnë nga Kapitulli II i Kushtetutës”.

Në lidhje me pretendimin e parashtruesve të kërkesës për shkelje të nenit 16 të Kushtetutës

60. Për sa i përket pretendimit të parashtruesve për shkelje të paragrafëve 1 dhe 2 dhe paragrafit 4 të nenit 16 të Kushtetutës, Presidenti u përgjigj: *“[...] Presidenti në asnjë mënyrë nuk ka vepruar në kundërshtim me nenin 16 paragrafët 1, 2 dhe 4, përmes deklarimeve në konferencën për media, më datë 23.03.2020. Madje, Presidenti me veprimet e tij ka mbrojtur parimet e kushtetutshmërisë, duke u kujdesur që vendimi i Qeverisë të jetë në pajtim me Kushtetutën dhe për këtë arsye edhe ka parashtruar kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, më datë 24.03.2020. Kushtetuta i ka dhënë kompetencë Presidentit, në bazë të nenit 113 që të kujdeset për kushtetutshmërinë e akteve të Qeverisë apo ligjeve të Kuvendit, me qëllim të ruajtjes dhe mbrojtjes së parimit të kushtetutshmërisë, bazuar në nenin 16, paragrafi 1 të Kushtetutës”.*

Në lidhje me pretendimin e parashtruesve të kërkesës për shkelje të nenit 93, paragrafit 4 të Kushtetutës

61. Në përgjigjen e tij ndaj pretendimit të parashtruesve për shkelje të paragrafit 4 të nenit 93 të Kushtetutës, Presidenti theksoi se: *“Presidenti, po ashtu, nuk e ka shkelur nenin 93, paragrafi 4 i Kushtetutës, siç pretendojnë parashtruesit e kërkesës. Presidenti përmes deklaratave të tij për moszbatim nuk ka ndërhyrë në kompetencën e Qeverisë për nxjerrjen e vendimeve. Për më tepër, Presidenti është kujdesur për kushtetutshmërinë e Vendimit të Qeverisë nr. 01/15, datë 23.03.2020, me qëllim të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut, si dhe me qëllim të garantimit të funksionimit kushtetues të institucioneve duke mbrojtur parimin e ndarjes së pushteteve, pasi që Qeveria përmes Vendimit nr.01/15, datë 23.03.2020, ka ndërhyrë në kompetencat e Kuvendit, duke cenuar parimin e ndarjes së pushteteve, liritë dhe të drejtat e njeriut, vlerat kushtetuese dhe parimin e barazisë para ligjit”.*

Në lidhje me pretendimin për shkelje të nenit 65, paragrafit 9 të Kushtetutës

62. Tutje, ndaj pretendimit të parashtruesve për shkelje të paragrafit 9 të nenit 65 të Kushtetutës, Presidenti u përgjigj: *“Presidenti përmes deklarimeve të tij në konferencën për media, të datës 23.03.2020, në asnjë mënyrë nuk e ka shkelur nenin 65, paragrafi 9 të Kushtetutës, siç pretendojnë parashtruesit e kërkesës. Përmes deklarimeve të tij, Presidenti në asnjë mënyrë nuk ka synuar që të ushtrojë mbikëqyrjen e punës së Qeverisë. Presidenti përmes veprimeve të tij, duke ushtruar kompetencat e tij vetëm i ka paralajmëruar qytetarët për pasojat kundërkushtetuese të vendimit të Qeverisë nr. 01/15, datë 23.03.2020, si dhe është kujdesur për funksionin demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, veçanërisht për mbrojtjen e parimit të ndarjes së pushteteve të cilën Qeveria e ka tejkaluar duke ushtruar kompetencat që i takojnë Kuvendit. Këtë siç u përmend disa herë më sipër e ka konstatuar Gjykata Kushtetuese në rastin KO54/20”.*

63. Ndërsa, përkitazi me rastin KO47/10, të cilit parashtuesit e kërkesës i referohen në kërkesën e tyre, Presidenti specifikoi se: *“Parashtuesit e kërkesës për të argumentuar gjoja shkeljen e Presidentit përmes deklarimeve të tij, krejtësisht jashtë kontekstit kanë cituar Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese në rastin KO47/10, sipas të cilit Gjykata Kushtetuese kishte konstatuar shkeljen serioze të Kushtetutës nga ish- Presidenti i Republikës së Kosovës z. Fatmir Sejdiu. Siç dihet botërisht, rrethanat e këtij rasti kanë qenë krejt të ndryshme nga rrethanat e tanishme, kjo për faktin se ish- Presidenti Sejdiu, edhe gjatë kohës sa ishte President, kishte lejuar vetveten që të figuronte si i regjistruar në listat e partisë së tij, LDK. Me këtë i njëjti kishte bërë shkelje të nenit 88.2 të Kushtetutës, pasi që kishte mbajtur postin e kryetarit të LDK-së, ndërkaq që këtë e ndalon shprehimisht Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 88.2 [...] Megjithatë edhe në rastin konkret, Presidenti i është drejtuar qytetarëve për t’i njoftuar për një gjendje të kundërkushtetutshmërisë së vendimit dhe për veprimet e tij që do t’i ndërmarrë, me qëllim të ruajtjes dhe mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve dhe mbrojtjes së vlerave demokratike që kultivon Kushtetuta. Qytetarët e Republikës së Kosovës presin që Presidenti si përfaqësues i unitetit të tyre të jetë i paanshëm dhe të ndërmarrë veprime në mbrojtjen e të drejtave të tyre që i garantohen me Kushtetutë”.*

Në lidhje me imunitetin funksional

64. Në vijim, Presidenti në përgjigjen e tij i referohet edhe imunitetit funksional. Në këtë kontekst, Presidenti i referohet Aktgjykimin të Gjykatës në rastin KO98/11, parashtues Qeveria e Republikës së Kosovës, Lidhur me imunitetin e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës, dhe anëtarëve të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Aktgjykim i 20 shtatorit 2011. Presidenti, duke iu referuar përmbajtjes së Aktgjykimin të lartcekur të Gjykatës nënvizon se: *“Nga ndërlidhja në mes të imunitetit funksional të deputetëve dhe Presidentit sipas pikave 58, 59 dhe 118 të Aktgjykimin në rastin KO98/11, nënkuptohet se deputetët kanë imunitet funksional në kryerjen e detyrave, brenda kompetencave të Kuvendit, siç përcaktohet me nenin 65 të Kushtetutës. Kjo nënkupton se imuniteti funksional i deputetëve është ajo çfarë ushtrohet brenda kompetencave të Kuvendit, ashtu siç përcaktohen në mënyrë taksative në nenin 65 të Kushtetutës. Në analogji me këtë, meqenëse Gjykata Kushtetuese ndjek një standard për imunitetin funksional të deputetëve dhe të Presidentit, nënkuptohet se imuniteti funksional i Presidentit është e gjitha ajo që ushtron Presidenti përmes kompetencave të tij që përcaktohen në nenin 83 dhe 84 të Kushtetutës, si dhe nenet tjera të Kushtetutës siç janë nenet: 4, 18, 60, 66, 69, 79, 80, 82, 93, 94, 95, 104, 109, 113, 114, 118, 126, 127, 129, 131, 136, 139 dhe 144”.*
65. Në përgjigjen e tij, Presidenti rithekson se në konferencën për media të mbajtur më 23 mars 2020 *“[...] nuk ka vepruar njëanshëm politikisht, por gjithnjë në të mirën publike dhe të interesit të qytetarëve dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut dhe të vlerave kushtetuese të Republikës së Kosovës. Në rrjedhë të kësaj konference, Presidenti më 24.03.2020 ka ndërmarrë dy veprime: e para ka dorëzuar kërkesën në Gjykatën Kushtetuese për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 01/15, datë 23.03.2020, si dhe e dyta, ka kërkuar nga Kryeministri që ta shfuqizojë*

vendimin në fjalë ose së paku të pezullojë implementimin e tij deri në vendimin e Gjykatës Kushtetuese”.

66. Në fund të përgjigjes së tij, Presidenti nxjerrë këto përfundime:

- (i) *Presidenti nuk ka shkelur asnjë nga nenet kushtetuese të pretenduara nga parashtruesit e kërkesës dhe kjo është konfirmuar dhe vërtetuar më vonë edhe nga Gjykata Kushtetuese me Aktgjykimin KO54/20;*
- (ii) *Presidenti në konferencën për media të 23 marsit 2020 nuk ka marrë vendim apo vendosur, por vetëm ka dhënë deklaratë duke pasur për bazë kompetencat e tij si përfaqësues i unitetit të popullit dhe garantues i funksionimit demokratik dhe kushtetues të institucioneve;*
- (iii) *Presidenti në bazë të kompetencave të tij kushtetuese, në deklaratimet e tij të datës 23 mars 2020, ka pasur për qëllim mbrojtjen e interesit qytetar dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut të përcaktuara në Kapitullin II dhe III të Kushtetutës;*
- (iv) *Presidenti në konferencën për media dhe me veprimet e mëpasshme ka deklaruar se ka pasur për qëllim mbrojtjen e parimit të ndarjes së pushteteve dhe moslejimit që Qeveria të ndërhyjë në kompetencat e Kuvendit;*
- (v) *Presidenti duke vepruar në kuadër të kompetencave të tij, ka vepruar brenda imunitetit funksional, të përcaktuar në nenin 89 të Kushtetutës dhe Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese në rastin KO98/11.*

67. Presidenti pretendoi se bazuar në argumentet e lartpërmendura, kërkesa nr. KO56/20 duhet të shpallet e papranueshme për shkak se është e papajtueshme *ratione materiae* me Kushtetutën.

68. Presidenti, përveç përgjigjes së tij ndaj pretendimeve të parashtruesve të kërkesës në Gjykatë dorëzoi edhe shkresat e dërguara Kryeministrit:

- (i) *Shkresa me nr. prot. 325, e 17 marsit 2020 për thirrjen e takimit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës për parandalim të përhapjes së koronavirusit COVID-19;*
- (ii) *Shkresa me nr. prot. 328, e 18 marsit 2020;*
- (iii) *Shkresa me nr. prot. 331, e 24 marsit 2020, përmes të cilës e informoi se Vendimin e Qeverisë, nr. 01/15, i 23 marsit 2020 e ka dërguar në Gjykatë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së tij dhe “Duke dashur që të ruhet rendi Kushtetues dhe ligjor në Kosovë, ju ftoj që të shfuqizoni vendimin e mbrëmshëm, ose së paku ta pezulloni implementinin e tij deri në vendimin e Gjykatës Kushtetuese”, dhe*
- (iv) *Shkresa me nr. prot. 333, e 24 marsit 2020 për thirrjen e takimit të Këshillit të Sigurisë me qëllim të diskutimit të zhvillimeve të fundit të gjendjes së sigurisë në Republikën e Kosovës.*

Komentet e parashtruesve të kërkesës ndaj përgjigjes së Presidentit

69. Fillimisht, parashtruesit e kërkesës theksojnë se “se në asnjë dispozitë kushtetuese nuk parashihet që Presidenti i Republikës së Kosovës mbron liritë dhe të drejtat e njeriut. Liritë dhe të drejtat e njeriut mbrohen përmes

mekanizmave të tjerë ligjor dhe kushtetues, varësisht nga natyra e shkeljes së këtyre lirive dhe të drejtave nga institucionet e Republikës së Kosovës. Prandaj, konsiderojmë se sistemi juridik i Kosovës ofron mekanizma ligjor dhe kushtetues të mjaftueshëm për të mbrojtur liritë dhe të drejtat e njeriut. [...]

70. Parashtruesit e kërkesës arsyetojnë se: “[...] vendimet e Qeverisë kishin të bëjnë me mbrojtjen e jetës së qytetarëve nga pandemia Covid-19, ndërsa sjellja e presidentit për të shpallur publikisht vendime të qeverisë pa efekt juridik kishte të bënte me ndërhyrjen brutale të cenimit të pavarësisë së pushtetit ekzekutiv dhe rrezikimin e lirive dhe të drejtave të njeriut duke bërë thirrje në atë mënyrë që ai që përkrah këto vendime konsumon vepër penale. Në këtë rast presidenti ka bërë shkelje të trefishtë kushtetuese. E para, ka uzurpuar kompetencën kushtetuese të Gjykatës Kushtetuese lidhur me shpalljen në mënyrë publike të vendimeve të qeverisë si antikushtetuese dhe pa efekt juridik në tërë territorin e Republikës së Kosovës. E dyta, në mënyrë kundërkushtetuese, dhe arbitrare i ka krijuar sanksion penal vendimeve të qeverisë në kuptimin e asaj që as organet e sigurisë dhe as qytetarët nuk duhet t’i zbatojnë këto vendime, sepse ndryshe konsumojnë vepër penale. Dhe e treta, ka cenuar rëndë ndarjen e pushteteve, konkretisht pavarësinë e pushtetit ekzekutiv, legjislativ dhe kompetencat e Gjykatës Kushtetuese, pa asnjë bazë kushtetuese. Kësisoj, Presidenti i Republikës ka nxitur qytetarët për veprime kundërligjore”.
71. Në vijim, parashtruesit e kërkesës përkritazi me arsyetimin e Presidentit se deklarata e tij është dhënë në përputhje me nenin 4.3 lidhur me nenin 84.2 të Kushtetutës së Kosovës, argumentojnë se: “Konstatimi i tillë i Presidentit është tërësisht i gabuar dhe i paqëndrueshëm sepse Presidenti nuk ka të drejtë të dal jashtë kompetencave të veta kushtetuese. Sepse nga parimi i ndarjes së pushteteve rrjedh, që dega ekzekutive duhet të ekzekutojë çdo vendim pa përjashtim dhe kjo është arsyeja pse presidenti nuk është i autorizuar të vendos se cilat vendime duhet të zbatohen, e cilat jo”.
72. Parashtruesit e kërkesës në komentet e tyre po ashtu theksojnë se “Neni 84.2 i Kushtetutës ka për qëllim të materializojë kompetencat specifike kushtetuese të parapara në nenin 84 të Kushtetutës. Asnjë kompetencë e tillë nuk e parasheh ndërhyrjen në pavarësinë e pushtetit ekzekutiv. [...] Çdo veprim i tillë i cili ndërhyr në kompetenca kushtetuese të qeverisë në emër të funksionimit demokratik të institucioneve kushtetuese pa bazë kushtetuese, shndërrohet në gardian kushtetues të Kosovës në mënyrë kundërkushtetuese. Në sistemin tonë kushtetues, Presidenti si gardian i Kushtetutës ka pozicion neutral dhe atij në këtë kuptim i njihet vetëm e drejta që të kontestojë vendime para Gjykatës Kushtetuese duke u thirr në kompetencat e tij, por jo të gjykojë apo konstatojë se vendimi i Qeverisë nuk ka efekte juridike dhe të bëjë thirrje për moszbatim dhe mosrespektim”.
73. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se “Presidenti në mënyrë të çuditshme në këto komente dhe pas sjelljes antikushtetuese thekson se ka pas një bindje të thellë se vendimi i Qeverisë pakëson liritë dhe të drejtat e njeriut, për këtë arsye ai ka thënë që nuk duhet të zbatohet vendimi i qeverisë. Në këtë aspekt mund të vërtetojmë se në deklaratën e bërë nuk e ka thënë këtë pretendim që lidhet me bindjen. Gjykata Kushtetuese nuk merret me bindje të cilat nuk janë shprehur apo nuk është sjellë në një formë publike të caktuar”.

74. Në komentet e tyre ndaj përgjigjes së Presidentit në lidhje me ndarjen e pushteteve, parashtuesit nënvizojnë se “ [...] Megjithëse këto pushtete janë të ndarë në aspektin e autonomisë funksionale dhe në pavarësinë e ushtrimit të detyrave të ngarkuara nga Kushtetuta, ato balancojnë njëri-tjetrin nëpërmjet bashkëveprimit ndërmjet tyre për ushtrimin e detyrave, duke respektuar, nxitur, mbështetur dhe kontrolluar njëri-tjetrin. Parimi i ndarjes së pushteteve nuk do kuptuar që çdo pushtet është i mbyllur dhe i pakontrolluar nga askush. Ndarja e pushteteve midis tri degëve të qeverisjes garantohej vetëm nëpërmjet sistemit të kontroleve dhe ekuilibrave. Në këtë mënyrë, sipas Kushtetutës, aq sa flitet për ndarje, bëhet fjalë edhe për ekuilibër të pushteteve. Qëllimi i një koncepti të tillë kushtetues siguron që të parandalohet çdo degë të qeverisjes për të ushtruar një pushtet të pakufizuar. Kontrollat dhe ekuilibrat që një Kushtetuta, i japin secilës degë, pushtete që kompensojnë apo zbusin ato të degëve të tjera. Ekzistojnë mjete apo mekanizma që balancojnë pushtetet, sepse në analizë të fundit, asnjë pushtet në vetë nuk është në gjendje të përmbushë misionin, nëse veprimtaria e tij nuk harmonizohet me veprimtarinë e pushteteve të tjera dhe nëse nuk sigurohet një ekuilibër, bashkërendim dhe kontroll reciprok, që natyrisht nuk ndërhyjnë në atë masë sa të dëmtojnë misionet e tyre kushtetuese. Në lidhje me këtë, mandati i Presidentit të Republikës është i pacenueshëm për të siguruar respektim të parimit të ndarjes së pushteteve dhe për ta ruajtur sigurinë në rendin juridik dhe kushtetues (shih rastet Ko29/12 dhe Ko48/12, Amendamentet e propozuara kushtetuese të dorëzuara nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 23 mars 2012 dhe më 4 maj 2012, Aktgjykimi i 20 korrikut 2012). Pra, argumentime të tilla kushtetuese dërgojnë në atë se Presidenti nuk mund të ndërhyjë në pavarësinë e ndarjes së pushteteve pa mekanizma kushtetues siç ka bërë në rastin e caktuar. Pra, presidenti materializon kompetencat e veta përmes nenit 84 të Kushtetutës së Kosovës. Kjo është rruga e vetme përmes së cilit siguron respektimin e ndarjes së pushtetit. Po ashtu, Presidenti i Republikës së Kosovës ka mekanizma të tjerë kushtetues sipas të cilave e përmes të cilave ka të drejtën e kontestimit të çdo vendimi të Qeverisë sipas nenit 113 të Kushtetutës. Presidenti ka ndërhyrë në kompetenca kushtetuese dhe në pavarësinë e pushtetit ekzekutiv në momentin që ka bërë një veprim të tillë antikushtetues me paramendim [...] Në lidhje me këtë, konsiderojmë se Presidenti pranon qartë se, në njërin anë ndërhyjnë në kompetencat e Qeverisë, duke e shpallur ai vet një vendim antikushtetues dhe pa efekt juridik në tërë territorin e Kosovës, kur dihet që një gjë e tillë është kompetencë ekskluzive e Gjykatës Kushtetuese. E dyta, përmes asaj sjellje ndërhyjnë në kompetencat e Kuvendit që përmes nenit 65 par.9 të mbikëqyrë punën e Qeverisë së Kosovës. Kësisoj, Presidenti në mënyrë antikushtetuese dhe me paramendim dëshiron që përmes shpalljes publike të vendimeve të qeverisë pa efekt juridik të ruaj ndarjen e pushteteve dhe balancimin e tyre, kur dihet se ndarja e pushteteve dhe balancimi i tyre bëhet përmes kompetencave kushtetuese të cilat i ushtrojnë ata, dhe çdo konflikt në mes tyre, autoritet i vetëm për t'i zgjidhë kontestet kushtetuese është Gjykata Kushtetuese, dhe jo Presidenti. Sepse kjo kompetencë në asnjë rrethanë nuk parashihet në nenin 84 të Kushtetutës së Kosovës. Për më tepër, Presidenti ka bërë këtë deklaratë me të cilën bënë thirrje për mosrespektim dhe moszbatim të vendimit të Qeverisë, para se të dorëzojë kërkesën në Gjykatën Kushtetuese, si dhe pa u marrë e pa u publikuar vendimi i Gjykatës Kushtetuese”.

75. Në komentet e tyre ndaj përgjigjes së Presidentit se ai ka kompetencë ekskluzive për t'u kujdesur për kushtetutshmërinë e akteve juridike me Kushtetutën, parashtuesit vlerësojnë se *"[...] Presidenti sërish devijon qëllimshëm shpjegimin e nenit 16 të Kushtetutës. Krejt kjo për faktin se Presidenti në bazë të nenit 84, par.6, ka të drejtën e kthimit për rishqyrtim të projektligjeve të miratuara nëse konsideron se janë të dëmshme për interesat legjitime të Republikës së Kosovës ose të një a më shumë të komuniteteve të saj. Kjo është adresa e vetme përmes së cilës Presidenti në një formë mund të kontestoj një projektligj të miratuar nga kuvendi nëse pretendon se është në kundërshtim me kushtetutën. Prandaj, Presidenti i Republikës ka vepruar në kundërshtim me vet nenin 16 të Kushtetutës sepse veprimi i tij ka qenë jashtë kompetencave kushtetuese të cilat ia përcakton Kushtetuta e Kosovës. [...] Kësisoj i vetmi organ i cili nuk ka vepruar në përputhje me kushtetutën e Kosovës, duke ndërhyrë në kompetencat e Qeverisë, Kuvendit dhe Gjykatës Kushtetuese, është Presidenti i Kosovës. Prandaj argumentimi është tejjet joprofesional, kontradiktor dhe jorelevant. Kësisoj, në fakt rikonfirmohen veprimet e tij, dhe mosrespektim i Kushtetutës, kompetencave të tij dhe pushteteve tjera. Këto veprime antikushtetuese të kryera me paramendim e cenojnë rendin kushtetues dhe bëjnë që niveli i besueshmërisë dhe kredibilitetit së zyrës së Presidentit të bie në nivelin më të ulët të mundshëm, gjë që, shkel edhe përfaqësimin e unitetit të popullit".*
76. Parashtuesit e kërkesës në komentet e tyre konkludojnë se *"Në komente të fundit të Presidentit shpërfaqet kontradikta në mes pretendimeve të tij për të ndërhyrë kinse me bazë "kushtetuese" në funksionimin e institucioneve kushtetuese dhe tentimit të tij për t'u fshehur prapa imunitetit funksional të pozicionit të Presidentit. Me fjalë të tjera, presidenti duke tentuar të fshihet prapa imunitetit funksional, ai e konfirmon veprimin antikushtetues të kryer me paramendim. Kësisoj në tërësinë e "argumenteve" të përcaktuara në këto komente vërehet vrulli për të ndërhyrë në pavarësinë kushtetuese të Qeverisë, Kuvendit dhe Gjykatës Kushtetuese, pa asnjë mbështetje kushtetuese, duke luajtur rolin e një individi i cili qëndron pa bazë kushtetuese mbi funksionimin kushtetues të institucioneve kushtetuese, si dhe përpjekja dëshpëruese e tij, për t'u fshehur prapa një imuniteti funksional, i cili nuk mbulon në asnjë rrethanë veprimin e tij antikushtetues". Në këtë rast, parashtuesit e kërkesës duke iu referuar rastit të Gjykatës KO98/11 nënvizojnë se ky rast "shpjegon qartë se imuniteti funksional janë imunitete funksionale për të siguruar që Presidenti nuk do të pengohet në kryerjen e detyrave shtetërore që i janë besuar atij institucioni me Kushtetutë.[...]".*
77. Në fund, parashtuesit e kërkesës konsiderojnë se *"[...] komentet e Presidentit konfirmojnë shkeljen e të gjitha neneve të Kushtetutës të përcaktuara në kërkesën e GP të Lëvizjes VETËVENDOSJE! të dorëzuar me datë 31 mars 2020 në Gjykatën Kushtetuese".*

Dispozitat relevante të Kushtetutës dhe të Ligjit nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës

Neni 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit]

[...]

3. *Presidenti i Republikës së Kosovës përfaqëson unitetin e popullit. Presidenti i Republikës së Kosovës është përfaqësues legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, në pajtim me këtë Kushtetutë.*

4. *Qeveria e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve e politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar.*

Neni 7 [Vlerat]

“1. Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.

2. Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore”.

Neni 16 [Epërsia e Kushtetutës]

“1. Kushtetuta është akti më i lartë juridik i Republikës së Kosovës. Ligjet dhe aktet e tjera juridike duhet të jenë në pajtim me këtë Kushtetutë.

2. Pushteti qeverisës buron nga Kushtetuta.

[...]

4. Secili person dhe organ në Republikën e Kosovës u nënshtrohet dispozitave të Kushtetutës”.

Neni 65 [Kompetencat e Kuvendit]

“Kuvendi i Republikës së Kosovës:

[...]

(9) mbikëqyr punën e Qeverisë dhe të institucioneve të tjera publike, të cilat, në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve, i raportojnë Kuvendit”.

Kapitulli V Presidenti i Republikës së Kosovës

Neni 83 [Statusi i Presidentit]

Presidenti është kreu i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit të Republikës së Kosovës.

Neni 84
[Kompetencat e Presidentit]

Presidenti i Republikës së Kosovës:

[...]

(2) garanton funksionimin kushtetues të institucioneve të përcaktuara me këtë Kushtetutë.

[...]

(20) emëron Komandantin e Forcave të Sigurisë të Kosovës, pas rekomandimit të Kryeministrit;

(21) së bashku me Kryeministrin, emëron Drejtorin, Zëvendësdrejtorin dhe Inspektorin e Përgjithshëm të Agjencisë së Kosovës për Intelegjencë;

(22) vendos për shpalljen e Gjendjes së Jashtëzakonshme, në konsultim me Kryeministrin; (23) mund të kërkojë mbledhje të Këshillit të Sigurisë të Kosovës dhe i kryeson ato në kohën e Gjendjes së Jashtëzakonshme;

(24) vendos për formimin e misionëve diplomatike e konsullare të Republikës së Kosovës, në bazë të konsultimit me Kryeministrin;

(25) emëron dhe shkarkon shefat e misionëve diplomatike të Republikës së Kosovës, me propozimin e Qeverisë;

[...]

Neni 93
[Kompetencat e Qeverisë]

“Qeveria ka këto kompetenca:

(1) propozon dhe zbaton politikën e brendshme dhe të jashtme të vendit;

(2) mundëson zhvillimin ekonomik të vendit;

[...]

(4) merr vendime dhe nxjerr akte juridike ose rregullore, të nevojshme për zbatimin e ligjeve”.

[...]

(8) i propozon Presidentit të Republikës së Kosovës emërimet dhe shkarkimet për shefa të misionëve diplomatike të Kosovës;

Neni 94
[Kompetencat e Kryeministrit]

Kryeministri ka këto kompetenca:

[...]

- (7) këshillohet me Presidentin e Republikës së Kosovës mbi çështjet e Inteligjencës;
(8) së bashku me Presidentin, emëron Drejtorin, Zëvendësdrejtorin dhe Inspektorin e Përgjithshëm të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë;
(9) këshillohet me Presidentin për zbatimin e politikës së jashtme të vendit;

Neni 97 [Përgjegjësia]

“1. Qeveria, për punën e vet, i përgjigjet Kuvendit të Kosovës.

2. Kryeministri, zëvendëskryeministrat dhe ministrat mbajnë bashkëpërgjegjësinë për vendimet që merr Qeveria, dhe përgjegjësinë individuale për vendimet që marrin në fushat e përgjegjësi të tyre”.

Përkitazi me procedurën e shqyrtimit të kërkesës

78. Në mënyrë që të vendosë lidhur me kërkesën e parashtruesve të kërkesës, Gjykata duhet të vlerësojë nëse janë përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe Rregullore të punës.
79. Në kontekst të kësaj, Gjykata fillimisht rikujton se parashtruesit e kërkesës, më 31 mars 2020, e dorëzuan kërkesën e tyre në Gjykatë, përmes të cilës pretendojnë se “veprimi” i Presidentit të Republikës së Kosovës i shprehur përmes deklaratës së tij në konferencën për media përbën shkelje serioze të Kushtetutës, respektivisht paragrafit 2 të nenit 84 [Kompetencat e Presidentit], paragrafëve 3 dhe 4 të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], paragrafit 1 të nenit 7 [Vlerat], paragrafëve 1 dhe 2 dhe paragrafit 4 të nenit 16 [Epërsia e Kushtetutës], paragrafit 4 të nenit 93 [Kompetencat e Qeverisë], nenit 97 [Përgjegjësia] dhe paragrafit 9 të nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit të Kosovës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
80. Si rrjedhojë e parashtrimit të kërkesës së parashtruesve, Gjykata, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi ndërmori të gjitha veprimet e nevojshme për njoftimin e palëve të interesuara për regjistrimin e kërkesës së tyre në Gjykatë, të cilat janë të reflektuar në paragrafët 8 deri 16 të këtij Vendimi.
81. Në lidhje me vlerësimin e pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata i referohet dispozitave përkatëse kushtetuese e ligjore sipas të cilave, deputetët mund të paraqiten si palë e autorizuar para kësaj Gjykate dhe të kërkojnë vlerësimin e pretendimit të tyre nëse Presidenti i Republikës së Kosovës ka kryer shkelje serioze të Kushtetutës.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”.

[...]

6. Tridhjetë (30) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, janë të autorizuar të ngrenë çështjen nëse Presidenti i Republikës së Kosovës ka kryer shkelje serioze të Kushtetutës.”

[...]

Ligji nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës

KREU III PROCEDURAT E VEÇANTA

9. Procedura në rastin e përcaktuar në nenin 113, paragrafi 6 të Kushtetutës

Neni 44 Saktësimi i kërkesës

1. Në kërkesën e ngritur në pajtim me nenin 113, paragrafi 6 të Kushtetutës, ndër të tjera, paraqiten informatat e mëposhtme:

1.1. përshkrimin e fakteve për shkeljen e pretenduar (supozuar);

1.2. dispozitat konkrete të Kushtetutës për të cilat pretendohet se i ka shkelur Presidenti; dhe

1.3 paraqitjen e provave mbi të cila mbështetet pretendimi për shkeljen e rëndë të Kushtetutës nga Presidenti i Republikës.

Neni 45 Afatet

Kërkesa duhet të parashtrohet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve që nga dita kur shkelja e pretenduar kushtetuese nga ana e Presidentit është bërë publike.

Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese

VII. Dispozita të veçanta për procedura sipas nenit 113 të Kushtetutës

Rregulli 75

Kërkesa në pajtim me nenin 113.6 të Kushtetutës dhe me nenet 44 dhe 45 të Ligjit

(1) Kërkesa, e parashtuar sipas këtij rregulli, duhet të përmbushë kriteret e përcaktuara në nenin 113.6 të Kushtetutës dhe me nenet 44 dhe 45 të Ligjit.

(2) Kërkesa, e bërë sipas këtij rregulli, duhet, inter alia, të paraqesë informatat e mëposhtme:

- (a) përshkrimin e fakteve për shkeljen e pretenduar;*
- (b) dispozitat konkrete të Kushtetutës për të cilat pretendohet se i ka shkelur Presidenti i Republikës së Kosovës; dhe*
- (c) paraqitjen e provave mbi të cilat mbështetet pretendimi për shkeljen e rëndë të Kushtetutës nga Presidenti i Republikës së Kosovës.*

(3) Pas paraqitjes së kërkesës në pajtim këtë rregull, Gjykata menjëherë njofton Presidentin e Republikës së Kosovës dhe i dërgon një kopje të kërkesës jo më vonë se tre (3) ditë nga paraqitja e saj në Gjykatë.

(4) Gjykata i kërkon Presidentit të Republikës së Kosovës që t'i përgjigjet kërkesës brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita kur kërkesa i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës, përveç rastit kur tregohet një arsye e mirë për një përgjigje të mëvonshme dhe kur jepet leja përkatëse.

(5) Gjykata urdhëron ndërprerjen e procedurave të iniciuara në pajtim këtë rregull në rast se para nxjerrjes së vendimit të saj, Presidenti i Republikës së Kosovës ka dhënë dorëheqje ose ka ndërprerë mandatin e tij/ saj.

(6) Në rast se pala e autorizuar e tërheq kërkesën, Presidenti i Republikës së Kosovës mund të kërkojë nga Gjykata të vazhdojë me procedurën dhe të nxjerrë vendim. Një kërkesë e tillë do të vendoset nga Gjykata me shumicën e gjyqtarëve.

(7) Kërkesa sipas këtij rregulli duhet të dorëzohet brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita kur shkelja e pretenduar kushtetuese nga ana e Presidentit është bërë publike.

[...]

82. Në vijim të kësaj, Gjykata duke u bazuar në të gjitha kriteret e përcaktuara me dispozitat e lartcekura të Kushtetutës, të Ligjit dhe Rregullores së punës konstaton se: (i) kërkesa është e parashtruar nga një palë e autorizuar siç është përcaktuar në paragrafin 6 të nenit 113 të Kushtetutës; (ii) kërkesa është parashtruar brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita kur shkelja e pretenduar kushtetuese nga ana e Presidentit është bërë publike, siç është përcaktuar me nenin 45 të Ligjit dhe paragrafin (1) të rregullit 75 të Rregullores së punës; dhe (iii) parashtruesit e kërkesës kanë saktësuar kërkesën e tyre ashtu siç është përcaktuar me nenin 44 të Ligjit dhe paragrafin (2) të rregullit 75 të Rregullores së punës.
83. Megjithatë, para se Gjykata të vendos përfundimisht në lidhje me kërkesën e parashtruesve të kërkesës, përmes të cilës pretendohet kryerja e shkeljes serioze e Kushtetutës nga Presidenti, më 5 nëntor 2020, Presidenti i Republikës së Kosovës dha dorëheqjen e tij nga pozita e Presidentit.
84. Në kontekst të rrethanës specifike, e cila është krijuar si rezultat i dorëheqjes së Presidentit nga pozita e tij si President i Republikës së Kosovës, Gjykata në këtë rast i referohet paragrafit (5) të Rregullit 75 të Rregullores së punës, i cili përcakton që:

(5) Gjykata urdhëron ndërprerjen e procedurave të iniciuara në pajtim këtë rregull në rast se para nxjerrjes së vendimit të saj, Presidenti i Republikës së Kosovës ka dhënë dorëheqje ose ka ndërprerë mandatin e tij/ saj.

85. Bazuar në këtë si më lart, Gjykata thekson se paragrafi (5) i rregullit 75 të Rregullores së punës, përcakton detyrimin e Gjykatës që të veprojë në pajtim me rrethanat e krijuara, gjegjësisht rrethanës së dhënies së dorëheqjes së Presidentit nga pozita e Presidentit pas procedurës së iniciuar, përkatësisht parashtrimin të kërkesës nga parashtruesit e kërkesës në pajtim me paragrafin 6 të nenit 113 të Kushtetutës dhe para nxjerrjes së vendimit të saj përfundimtar në lidhje me kërkesën. Kjo dispozitë e Rregullores së punës, në mënyrë shprehimore përcakton që në rastin e dhënies së dorëheqjes apo ndërprerjes së mandatit të Presidentit para nxjerrjes së vendimit të saj përkitazi me vlerësimin e pretendimit nëse Presidenti ka kryer shkelje serioze të Kushtetutës, Gjykata urdhëron ndërprerjen e procedurave të iniciuara në bazë të paragrafit 6 të nenit 113 të Kushtetutës.
86. Gjykata rikujton se Deklarata e Presidentit në konferencën për media e 23 marsit 2020 është dhënë në ndërlidhje me një vendim të degës ekzekutive për një seri masash kufizuese për qytetarët e Republikës së Kosovës.
87. Thënë këtë, Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Presidenti përmes Deklaratës së tij ka kryer shkelje serioze të Kushtetutës, në mënyrë specifike duke pretenduar se (i) Presidenti përmes deklaratës së tij për thirrje të moszbatimit të Vendimit të Qeverisë ka “uzurpuar kompetencën ekskluzive të gjykatave” dhe në mënyrë “flagrante ka shkelur ndarjen demokratike në mes gjykatave dhe institucioneve tjera”; (ii) që shkelja e paragrafit 2 të nenit 84 [Kompetencat e Presidentit], paragrafëve 3 dhe 4 të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], paragrafit 1 të nenit 7 [Vlerat], paragrafëve 1 dhe 2, dhe paragrafit 4 të nenit 16 [Epërsia e Kushtetutës], paragrafit 4 të nenit 93 [Kompetencat e Qeverisë], nenit 97 [Përgjegjësia] dhe paragrafit 9 të nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit të Kosovës] të Kushtetutës nga Presidenti i Republikës së Kosovës, “ka bërë që niveli i besueshmërisë publike të Presidentit të cenohet skajshmërisht”; dhe (iii) duke iu referuar gjendjes emergjente të shëndetit publik, Presidenti me thirrjen e tij për moszbatim të Vendimit të Qeverisë përmes deklaratës së tij publike ka “rrezikuar drejtëpërsëdrejti shëndetin dhe jetën e qytetarëve”.
88. Prandaj, bazuar në atë si më lart, Gjykata vlerëson se pretendimet për kryerjen e shkeljes serioze nga Presidenti në mënyrë specifike ndërlidhen me veprimet e Presidentit gjatë ushtrimit të funksionit të tij si President, dhe për pasojë përgjegjësia e Presidentit apo pretendimi për shkelje serioze të Kushtetutës ndërlidhet ekskluzivisht me ushtrimin e funksionit të tij si President.
89. Në kontekst të kësaj, dhe duke iu referuar paragrafit 6 të nenit 113 të Kushtetutës është përcaktuar që subjekt i vlerësimit të Gjykatës është "Presidenti i Republikës", përkatësisht vlerësimi nëse një veprim specifik i Presidentit të Republikës paraqet shkelje serioze të Kushtetutës. Rrjedhimisht, dhe bazuar në rregullin 75, paragrafin (5), të Rregullores së punës, Gjykata vlerëson se procedura e shqyrtimit apo vlerësimit nëse Presidenti ka kryer shkelje serioze të Kushtetutës nuk mund të vazhdohet edhe në rastin kur personi ndaj të cilit është

ngritur pretendimi për kryerje të shkeljes serioze të Kushtetutës nuk është duke e ushtruar atë funksion. Thënë këtë, sapo pozita e Presidentit apo ushtrimi i funksionit të tij si President pushon së ekzistuari, në këtë rast si rezultat i dorëheqjes së tij, ushtruesi i mëparshëm i këtij funksioni, i cili është subjekt i vlerësimit të Gjykatës nëse ka kryer shkelje serioze, nuk mund të vazhdojë të jetë palë në procedurën e shqyrtimit të kërkesës të parashtruar në pajtim me nenin 113, paragrafin 6 të Kushtetutës, jo vetëm për faktin e thjesht që personi vendimi ose veprim i të cilit është subjekt shqyrtimi nuk është në detyrë, por edhe atë që masa e përcaktuar në paragrafin 3 të nenit 91 të Kushtetutës bëhet e pazbatueshme.

90. Në këtë rast, Gjykata i referohet paragrafit 3 të nenit 91 [Shkarkimi i Presidentit] të Kushtetutës, i cili përcakton që:

3. Nëse Presidenti i Republikës së Kosovës është dënuar për ndonjë krim të rëndë ose kur nëse Kuvendi, në pajtim me këtë nen, konstaton që Presidenti nuk është i aftë të ushtrojë përgjegjësitë e tij/saj për shkak të sëmundjes së rëndë ose nëse Gjykata Kushtetuese konstaton se ajo/ai ka bërë shkelje të rëndë të Kushtetutës, Kuvendi mund të shkarkojë Presidentin me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të tij.

91. Duke qenë që Presidenti ka dhënë tashmë dorëheqje dhe nuk është në detyrë, ky fakt e bën dispozitën e paragrafit 3 të nenit 91 të Kushtetutës të pazbatueshëm, në kuptimin që Kuvendi nuk ka se si ta shkarkonte atë edhe po qe se Gjykata do të gjente se ai ka bërë shkelje të rëndë të Kushtetutës.
92. Bazuar në atë si më lartë, Gjykata thekson se në rast se ushtrimi i funksionit të Presidentit është përfunduar si rezultat i dorëheqjes së tij, atëherë nuk mund të vihet në lëvizje paragrafi 3 i nenit 91 të Kushtetutës.
93. Në këtë rast, Gjykata po ashtu bën dallimin në mes të kërkesës së parashtruar në bazë të paragrafit 2 të nenit 113 të Kushtetutës dhe kërkesës së parashtruar në bazë të paragrafit 6 të nenit 113 të Kushtetutës.
94. Përderisa bazuar në paragrafin 2 të nenit 113 të Kushtetutës, objekt vlerësimi është, përveç tjerash, çështja e përputhshmërisë së dekreteve të Presidentit me Kushtetutën, gjë që është e pavarur nga personi që e ushtron funksionin e Presidentit dhe fakti nëse i njëjti vazhdon të jetë në detyrë ose jo, në rastin e paragrafit 6 të nenit 113, çështja është e lidhur me personin që e ushtron funksionin dhe vlerësimin nëse i njëjti ka kryer shkelje ose jo, përcaktim ky që ka efekte të drejtpërdrejta për bartësin e funksionit. Thënë ndryshe, në rastin e një çështjeje që ngritet në mënyrë të vlefshme mbi bazën e paragrafit 2 të nenit 113, Gjykata mund të vendosë për kushtetutshmërinë e një dekreti të Presidentit, pavarësisht nga fakti nëse Presidenti që ka nxjerrë dekretin e kontestuar është në detyrë ose duke ushtruar funksionin ose jo. Në këtë rast, Gjykata do të detyrohej që ta vlerësojë në merita ligjin apo dekretin e kontestuar për shkak të pasojave juridike të vazhdueshme që do të prodhonte akti i tillë pavarësisht dorëheqjes së Presidentit.
95. Në rrethanat e rastit konkret, kërkesa është dorëzuar në kuadër të paragrafit 6 të nenit 113 të Kushtetutës me ç 'rast parashtruesit e kërkesës kontestojnë

kushtetutshmërinë e deklaratës së Presidentit të dhënë më 23 mars 2020. Thënë këtë, deklarata e kontestuar nuk përbën as ligj e as dekret nga neni 113.2 i Kushtetutës, por përbën veprim, i cili ndërlidhet ekskluzivisht me ushtrimin e funksionit të tij si President, tanimë të dorëhequr.

96. Rrjedhimisht, bazuar në faktin se kërkesa është dorëzuar në bazë të nenit 113, paragrafit 6 të Kushtetutës me ç' rast parashtruesit e kërkesës e kontestojnë kushtetutshmërinë e veprimit të Presidentit përmes Deklaratës së tij të dhënë më 23 mars 2020, i cili veprim rrjedhimisht, ndërlidhet me kërkesën për konstatimin e një shkelje serioze që do të mund të rezultonte në shkarkimin e Presidentit, ndërsa Presidenti më nuk ushtron këtë detyrë, Gjykata në përputhje me nenin 113.6 të Kushtetutës, nenet 44 dhe 45 të Ligjit, dhe rregullin 75 (5) të Rregullores së punës konstaton se më nuk ka rast para vetes dhe rrjedhimisht duhet të vendos për ndërprerjen e procedurave të shqyrtimit të mëtejme të kërkesës.

Kërkesa për mbajtjen e seancës dëgjimore publike

97. Gjykata rikujton gjithashtu që parashtruesit e kërkesës kanë kërkuar mbajtjen e seancës dëgjimore publike. Në kontekst të kërkesës së tyre, parashtruesit e kërkesës theksojnë se: *"[...] është në interes publik që të mbahet kjo seancë dëgjimore publike, për shkak se rasti në fjalë afekton jo vetëm organet shtetërore dhe kompetencat e tyre kushtetuese por edhe shoqërinë në tërësi. Ashtu siç është argumentuar më lart, veprimi antikushtetues i Presidentit cenon parime të rëndësishme të funksionimit të Republikës sonë"*.
98. Në këtë rast, Gjykata rikujton paragrafin 2 të rregullit 42 [E drejta në dëgjim dhe heqja dorë] të Rregullores së punës që përcakton:

"Gjykata mund të urdhërojë mbajtjen e seancës dëgjimore në rast se beson se ajo është e nevojshme për të qartësuar çështje të provave apo të ligjit."

99. Marre për bazë urdhrin e Gjykatës për ndërprerjen e procedurës së shqyrtimit të kërkesës si pasojë e dhënies së dorëheqjes së Presidentit nga pozita e Presidentit, ky urdhër i Gjykatës i referohet edhe ndërprerjes së shqyrtimit të kërkesës së parashtruesve të kërkesës për mbajtjen e seancës dëgjimore.

Përfundim

100. Gjykata, bazuar në rrethanat e krijuara pas dorëzimit të kërkesës nga parashtruesit e kërkesës, si pasojë e dorëheqjes së Presidentit, dhe bazuar në faktin se kërkesa është dorëzuar në bazë të nenit 113, paragrafit 6 të Kushtetutës me ç' rast parashtruesit e kërkesës e kontestojnë kushtetutshmërinë e veprimit të Presidentit përmes Deklaratës së tij të dhënë më 23 mars 2020, i cili veprim rrjedhimisht, ndërlidhet me kërkesën për konstatimin e një shkelje serioze që do të mund të rezultonte në shkarkimin e Presidentit, ndërsa Presidenti më nuk ushtron këtë detyrë, Gjykata në përputhje me nenin 113.6 të Kushtetutës, nenet 44 dhe 45 të Ligjit, dhe rregullat 59 dhe 75 (5) të Rregullores së punës konstaton se më nuk ka rast para vetes dhe rrjedhimisht duhet të vendos për ndërprerjen e procedurave të shqyrtimit të mëtejme të kërkesës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113, paragrafin 6 të Kushtetutës, nenet 44 dhe 45 të Ligjit, rregullin 59 dhe paragrafin (5) të rregullit 75 të Rregullores së punës, më 17 dhjetor 2020, njëzëri:

VENDOS

- I. TË NDËRPRERJË procedurën e shqyrtimit të kërkesës së parashtruesve të kërkesës;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky VENDIM hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Bajram Ljati



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi